



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Elbasan, më . . .2026

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS - “F.v. kamera dedektimi për mbrojtjen nga zjarri”.

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë – Mallra”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: Paketa software dhe sisteme informacioni 48000000-8, Servera 48820000-2, Kamera sigurie 32351200-0

VLERA E FONDIT LIMIT - 27,421,733 (njëzet e shtatë milion e katërqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) **lekë pa t.v.sh.**, ose **288,619** (dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) **Euro pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026, 2027.

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet

e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr.10 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteri (1- a) është vendosur në bazë. bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në piken 1 të nenit 82 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar percaktohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kriteri (1-b) është vendosur bazuar në nenin 83 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenin 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në piken 1 të nenit 83 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe piken 1 të nenit 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar percaktohet: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 8.

2.1.1 Operatori ekonomik duhet te kete paguar **taksat dhe tarifave vendore për vitin 2026 (këstet e maturuara)** ose taksat dhe tarifave vendore per vitin **2025** per ato bashki te cilat me vendim te keshillit bashkiak, afati per pagimin e taksave dhe tarifave vendore (kestet e maturuara) eshte pertej dates se zhvillimit te procedures, te percaktuar ne njoftim e kontrates. Pagesa e taksave dhe tarifave vendore duhet te behet për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të ligjin nr.162 date 23.12.2020 "Per prokurimin Publik", i ndryshuar; ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

Ne nenin 76, pika 2 të LPP parashikohet: Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia.

Ne nenin 2, germa ç, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet: Ky ligj zbatohet për:

ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

Ne nenin 4, pika 1 dhe 3, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimet dhe taksat janë kombëtare ose vendore.

3. Tatimet dhe taksat vendore përcaktohen në ligjin për sistemin e taksave vendore.

Ne neni 43 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, siç përcaktohet në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.

1/2. Edhe personi fizik tregtar i pajisur me NIPT/NUIS, për çdo veprimtari të re që kërkontë regjistrojë, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re.

Ne nenin 5 të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet: Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak:

a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuara në këtë ligj;

b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuara në këtë ligj, për çdo kategori nënkategori të bazës së taksës;

c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet. Kërkesa konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; si dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Ne nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjithatë ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personatfizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vititpasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.

Ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nder te tjera parashikohet:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Sa mesiper, duke qene se lloji i procedures eshte e hapur mbi kufirin e larte monetar, eshte kerkuar qe vlera minimale e xhiros vjetore per tu permbushuar nga operatorët ekonomikë te jete sa fondi limit.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Nenin 77, te ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nder te tjera parashikohet:

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Ne nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjithatë ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. **Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.**

Ne nenin 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar përcaktohet se:

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:

a) të gjitha njësitet ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik;

b) të gjitha njësitet ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;

iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perllëgaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvijes se mëparshme te realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqese vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvija e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotesuara sipas kërkesave të legjisllacionit ne fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri 2.3.1 është vendosur bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvijën e nevojshme për të zbatuar kontratën. *Ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvijën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvije që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvijën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Ne pikën 4 të nenit 40 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Për të provuar përvijën e mëparshme, Autoriteti/Enti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf kryesor teknik dhe punonjes te kualifikuar, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, si mëposhtë:

- 1 (një) Inxhinier elektronik
- 1 (një) Inxhinier elektrik
- 1 (një) Inxhinier telekomunikacioni
- 1 (një) punonjës të çertifikuar në Menaxhimin e Projekteve Profesionale lëshuar nga Project Management Institute (P M I) ose ekuivalente.
- 1 (një) punonjes te certifikuar ITIL Foundation Certificate in IT Service Managment ose ekuivalente.
- 5 (pesë) punonjës teknik/montues të pajisjeve elektronike të certifikuar/trajnuar nga kompania prodhuese si me poshte:

- 2 punonjes të certifikuar/trajnuar nga kompania prodhuese e kamerës termale që do të ofertohej
- 1 punonjës i certifikuar/trajnuar nga kompania prodhuese për sistemin e videowall që do të ofertohej
- 2 punonjës të certifikuar/trajnuar nga kompania prodhuese për sistemin e alarmit dhe mbrojtjes perimetrale që do të ofertohej

Për inxhinieret e mësipërme duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe diploma, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Për punonjësit e kualifikuar, përveç certifikatave duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Shenim: Ky kriter mund të plotësohet edhe nëse një punonjes mund të zotërojë me shumë se një certifikim.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjeteve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Në nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

a) *licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Inxhinieri elektronik është personi që do të angazhohet drejtpërdrejtë në mbikqyrjen e proceseve të instalimit të kamerës termale dhe pajisjeve të tjera, të cilat janë pajisje elektronike dhe gjithashtu do të asistojë AK në rast defektesh gjatë periudhës së garancisë. Kamera termike me rreze të gjatë veprimi (deri në 15 km) është një pajisje komplekse opto-elektronike. Kërkesa për një Inxhinier Elektronik është e domosdoshme pasi ky specialist garanton kuptueshmërinë dhe kalibrimin e sensorëve termalë, mikrobolometrave, procesimit të sinjalit të imazhit termik dhe integritetit të tyre me sistemet qendrore. Ky profil menaxhon parametrat delikatë të ndjeshmërisë termike dhe kalibrimit të lentes në varësi të kushteve atmosferike.

Inxhinieri elektrik është personi, i cili do të mbikqyrë dhe drejtojë të gjithë proceset dhe lidhjet e nevojshme me rrjetin e energjisë elektrike dhe do të garantojë zbatimin e rregullave teknike sipas ligjit Nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, indryshuar. Çdo projekt i monitorimit me kamera në distanca të tilla kërkon infrastrukturë të dedikuar elektrike, sisteme të mbrojtjes nga mbingarkesat (Surge Protection), mbrojtje nga rrufetë (tokëzime profesionale pasi kamerat vendosen në pika të larta dhe të ekspozuara), si dhe llogaritjen e saktë të sistemeve të ushqimit me energji të pandërprerë (UPS ose panele solare nëse janë pika të izoluara). Prania e inxhinierit elektrik garanton sigurinë elektrike të pajisjeve me vlerë të lartë dhe përputhshmërinë me normat teknike të instalimeve elektrike.

Inxhinieri i telekomunikacionit është personi, i cili do të mbikqyrë dhe drejtojë të gjithë proceset dhe lidhjet e nevojshme ndërmjet antenave për transmetimin e sinjalit nga kulla ku do të montohet kamera termale në sallën e monitorimit pranë Bashkisë Elbasan. Duke qenë se kamera operon në një distancë deri në 15 km, transmetimi i sinjalit të videos (me rezolucion dhe bitrate të lartë) drejt qendrës së monitorimit nuk mund të bëhet me kabullo standarde. Ky transmetim kërkon linja me fibër optike me rreze të gjatë ose linke wireless profesionale pikë-më-pikë (P2P Microwave links) që kërkojnë llogaritje të zonës Fresnel, fitimit të antenave dhe stabilitetit të brezit të transmetimit. Inxhinieri i Telekomunikacionit është përgjegjës për të garantuar që sinjali vjen pa vonesa (latency) dhe pa ndërprerje në qendër.

Duke qenë se kontrata ka një vlerë të konsiderueshme dhe përfshin fazën e ndryshme: prokurim, import specifik të pajisjes, instalim fizik, konfigurim rrjeti dhe fazën e testimit, një menaxher projekti i certifikuar nga PMI (ose ekuivalent) garanton që operatori ekonomik ka kapacitet menaxhues për të respektuar afatet kohore, për të menaxhuar risqet e projektit dhe për të koordinuar në mënyrë profesionale burimet njerëzore dhe logjistike për të krijuar vonesa në dorëzimin e veprës.

Ky projekt nuk mbaron me montimin fizik të kamerës. Ai përfshin integrimin e saj në një strukturë ekzistuese të shërbimeve IT (si dhomat e serverave, sistemet e monitorimit NVR/VMS, ruajtjen e të dhënave dhe sigurinë kibernetike). Certifikimi ITIL dëshmon se stafi i operatorit zbaton praktikën më të mirë ndërkombëtare për menaxhimin e shërbimeve të TI-së, incidenteve dhe mirëmbajtjes, duke siguruar që sistemi i ri të integrohet pa krijuar konflikte në infrastrukturën ekzistuese të institucionit.

Kamerat termike të distancave të mëdha (15 km) janë pajisje tejet specifike dhe të shtrenjta. Një gabim minimal gjatë montimit mekanik, fokusimit apo izolimit nga lagështira mund të shkatërrojë pajisjen ose të nxjerrë jashtë funksionit investimin. Kërkesa që stafi teknik të jetë i trajnuar drejtpërdrejt nga kompania prodhuese (ose distributori i autorizuar) garanton që montimi do të bëhet fiks sipas manualeve të fabrikës, duke ruajtur kështu edhe validitetin e garancisë së pajisjes.

Montuesit/teknikët do të jenë personat e drejtpërdrejtë që do të angazhohen në kryejren e punimeve për furnizim-vendosjen e kamerës termale, sistemit të kamerave të vezhimit, sistemit të alarmit, videowallin etj. Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi i kamerës termale është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e pajisjes brenda afatit të realizimit të kontratës pasi kanë marrë të gjithë njohuritë e nevojshme për produktin që do të montojnë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht **10 (dhjete)** punonjës për 3 muajt e fundit, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton për disponueshmerinë e stafit, do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pariperpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar.

Ne nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Në nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Nga ana e AK është kërkuar një numër punonjësish prej 10 personash, sepse kontrata është komplekse, dhe kërkohen punonjës të specializuar në procese specifike të furnizimit/instalimit dhe mirembajtjes së mallrave objekt prokurimi. Përcaktimi mesatarisht i 10 punonjesve është bere duke marre parasysh punonjesit e kerkuar si staf kryesor teknik dhe punonjesit e kualifikuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe te paraqese çertifikaten e vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 “Sistemi i Menaxhimit të Cilesise” ose ekuivalente, e vlefshme
- SSH/EN-ISO 27001 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit” ose ekuivalente, e vlefshme
- SSH/EN-ISO 20000-1 “Për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise se informacionit” ose ekuivalente, e vlefshme

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoje sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nder te tjera parashikohet se : Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga

Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nder te tjera parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura, të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 27001 është standardi më i njohur për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS). Ai përcakton kërkesat që një ISMS duhet të përmbushë.

Standardi ISO 27001 u ofron kompanive të çdo madhësie dhe nga të gjithë sektorët e aktivitetit udhëzime për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Përputhshmëria me ISO 27001 do të thotë që një organizatë ose biznes ka vënë në vend një sistem për të menaxhuar rreziqet që lidhen me sigurinë e të dhënave në pronësi ose të trajtuara nga kompania, dhe se ky sistem respekton të gjitha praktikat dhe parimet më të mira të mishëruara në këtë Standard Ndërkombëtar.

Ky standart siguron mbrojtjen e të dhënave sensitive, minimizon rreziqet e aksesit të paautorizuar, dhe garanton një qasje të strukturuar ndaj menaxhimit të sigurisë kibernetike.

ISO 20000-1 është standardi kryesor ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit (ITSM), i cili përcakton kërkesat për planifikimin, krijimin, zbatimin, operimin, monitorimin, rishikimin dhe përmirësimin e një Sistemi Menaxhimi të Shërbimeve (SMS). Ai u mundëson organizatave të ofrojnë shërbime IT me cilësi të lartë dhe të qëndrueshme, duke i përshtatur ato me qëllimet e biznesit dhe nevojat e klientëve.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të prodhuesit/ve ose Distributorit të autorizuar prej prodhuesit për furnizimin e listës së artikujve si më poshte:

1. Kamera Termale me dedektim zjarri dhe identifikim njerezish dhe mjetesh;
2. Software për monitorimin dhe menaxhimin e kamerave termale, sistemit të vëzhgimit perimetral, videowall
3. Sistem Alarmi Wireless (përfshirë sirene, tastiere, bateri, 2 pulte komandimi, buton emergjence, repetitor
4. Sensor lëvizje wireless

5. NVR 8 kanale inteligjente
6. Kamera te jashteme 8 MPX IP inteligjente
7. Switch PoE 8 Porta
8. Switch 16 Porta Gigabit
9. Monitor per Video Wall 24/7
10. Modul Menaxhimi per Video Wall

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij kurse në rastin e Autorizimit nga Distributori i Autorizuar do te paraqitet dhe akt-marreveshja/akti perkates

Argumentimi: Kriteri eshte vendosur bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ne nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nder te tjera parashikohet: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ne pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Kështu autorizimi i prodhuesit apo distributorit të autorizuar, tregon nëse OE kanë mundësinë të ofrojnë mallra origjinale, në cilësi dhe me standarde ndërkombëtare, duke garantuar mbështetjen e kompanisë prodhuese/distributore gjatë procesit të furnizimit/vendosjes e instalimit dhe mirëmbajtjes gjatë periudhës së garancisë, si dhe me

qëllim verifikimin e origjinës së mallrave dhe të dhënave të tjera të deklaruara mbi prodhuesin. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.

2.3.6 Për të vërtetuar përputhshmërinë me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kataloget/skemat teknike (datasheet) nga prodhuesi i mallrave që oferton, për produktet e percaktuara **ne pikën 2.3.5.**

Argumentimi : Kriteri është vendosur bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre

Ky kriter është vendosur për të garantuar Autoritetin Kontraktor se artikujt e ofruar do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me atë të deklaruar në ofertë dhe që përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) automjete të përshtatshme për transport mallrash, për të cilat duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Lejen e qarkullimit

- Policën e sigurimit
- Çertifikaten e kontrollit teknik
- Taksat vjetore

Në rast se mjetet e lartpërmendura janë marrë me qira ofertuesi duhet të paraqesë kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjeteve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kriteri është vendosur bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në pikën 5/ç, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në pikën 5/ç, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës brenda afateve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar nga specialisti fushes, anetar i njesise se prokurimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT